



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

VENDIM

Nr. 37 Datë 08.08.2025

PËR

MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS

31.07.2025

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), neni 53/8, ligji nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike“, si dhe Vendimin Nr. 22, datë 25.02.2020 „Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Kukës“, neni 88,

VENDOSI

1. Të miratojë procesverbalin e mbledhjes së datës 31.07.2025 bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS
PROCESVERBAL

Mbledhja e dates 31.07.2025

I mbajtur sot me datë 31.07.2025, ora 11:00.

U zhvillua mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak. Mbledhja është thirrur me njoftimin e datës 24.07.2025

Morën pjesë: **Albert Muja, Fasli Gërmizi, Erjon Brati, Gazmend Hallaçi, Rustem Ahmetaj, Bledar Lleshaj, Destan Spahiu, Arjeta Zela, Ervis Gjana, Hume Elezaj, Astrit Dobrush, Xhem Visha, Vebi Bajraktari, Sami Mata, Republika Tusha, Edmond Hallaçi**

Konstatohet kuorumi i nevojshëm për fillimin e mbledhjes. Kryetari i Këshillit lexon rendin e ditës

1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 02.06.2025.

2.Projektvendim për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, QERSHOR 2025.

3.Projektvendim për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028, faza 2”

4.Projektvendim për dhënien e titullit “Qytetar nderi” i bashkisë Kukës z. Qemal Sulejman Parllaku”.

5.Raportim i kryetarit të bashkisë në lidhje me kthimin e lulishtes së qytetit në park lojërash.

Të ndryshme (ankesë e banorëve të lagjes 3 për lirimin e hapsirës publike, informacion nga drejtoria e rrugëve për mirëmbajtjen e segmentit rrugor Ura e Koloshit-Zapod”)

Fasli Gërmizi: Banorët e Shishtavecit ankohen për mungesë uji, keqmenaxhim i mbetjeve urbane, ujërave të zeza, rrugës hyrëse të njësisë) Tubat e ujit të pijshëm nuk janë investuar prej vitesh dhe nuk mirëmbahen. Nuk kanë ku kërkojnë llogari për problemet e tyre. Edhe Kukësi po vuan për ujin e pijshëm. Shqetësim tjetër nga banorët e njësisë Grykë-Cajë...Kalimi i ujit të fshatrave në tubat e HEC-eve ka bërë që ata të jenë pa ujë për vadtje. Ne jemi për mbrojtjen e interesave të qytetarëve dhe t’ju krijojmë kushte atyre.

Në park janë vënë disa lojëra. Investimi është bërë aq shpejt. Orari është i kufizuar. Këto lojëra duhet të instalohen në shkolla si dhe shpërndahen nëpër lagje që të mos jetë e nevojshme të vijnë fëmijët nga lagjia e re apo Gostili., etj. Bëj apel të jemi mbështetje e banorëve dhe fëmijët të ndihen të barabartë. Këtu ka kohë që prioritetet ndahen në varësi të dhurimit të projekteve.

Sami Mata: Pse nuk kalojnë asetet e ujësjellësit në inventar?

Sa i përket ankesës së banorëve të lagjes 3, pse nuk zbatohet projekti?

Albert Muja: Banorët kanë bërë ankesa të vazhdueshme dhe nuk po marrin përgjigje. Po veprohet me 2 standarte. Në lagjen 2 ka lirim të hapsirave publike, ndërsa në lagjen 3 jo.

A ka bashkia një plan inspektimi për këtë?

Erta Palushi: Ne kemi një mbikëqyrje por nuk jam përgjegjëse për këtë pjesë.

Astrit Dobrushit: Sa i përket Shishtavecit, mbase keni të drejtë për ankesat, por jo për Grykë-Cajën. HEC është koncension i shtetit. Jeni kundër zhvillimit të

Fasli Gërmizi: Jam në mbrojtje të qytetarëve.

Miratohet rendi i ditës.

Pika 1. Miratohet

Pika 2:

Bashkim Guri: 416 familje do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin qershor. Kemi 3 familje më pak.

Nuk ka diskutime. Miratohet.

Pika 3:

Nuk ka kaluar në mbledhje të komisionit.

Albert Muja: Kam disa kërkesa të cilat do t'ju dërgoj edhe me shkrim në lidhje me PBA 2026-2028.

R.Hereni: Projektvendimi shpjegon tavanet përfundimtare të shpenzimeve.

Z. Jata: Miratimi i tavaneve ka të bëjë me kufinj të limitit. Ne kemi qenë prezent në 2 mbledhje.

Pika 4:

Fasli Gërmizi: Komisioni u mblodh. Dokumentacioni është shumë korrekt. Dua të përgëzoj grupin nismëtar. Kjo figurë ka lënë gjurmë që duhet të ishin kthyer në model. Ishte korrekt, njerëzor, pro ligjit. Duhet të shërbejë si model për drejtuesit actual dhe më tutje.

Hidhet në votim. Miratohet me të gjitha votat pro.

Lidhur me kthimin e lulishtes në park lojërash, Erta Palushi shprehet: _Nuk ka ndryshuar destinacioni. Lulishtja e qytetit është pasuruar me disa lojëra të cilat i kemi dhuratë.

Lidhur me kërkesën e z. Sajmir Cengu për 5 vende parkimi për biznesin e tij, Erta Palushi: Në rrethrotullim është e pamundur sipas kodit rrugor. Subjektit I kemi rekomanduar vendin ku mund të marrë vendparkimet. Është zgjedhje e tyre.

Kërkesa nga ujësjellësi për ndryshimin e tarifave të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura.

Anëtarët e këshillit bashkiak: Uji po pakësohet cdo ditë dhe të rritet cmimi, është e papranueshme. Kukësi po vuan për ujë.

Fasli Gërmizi: Kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të raportohet për ecurinë e mirëmbajtjes së objekteve shkollore (të detajuar për cdo njësi).

Mbyllet mbledhja në orën 11:46

Kukës, datë 31.07.2025

Kryetari i Këshillit

Albert MUJA

Sekretari i Këshillit

Eridona RAMALLARI